



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PAKR.nr.101/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti i Krimeve të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Beqir Kalludra, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit I.B., nga Gjakova, duke vendosur përkitazi me kërkesën për bashkimin e dënimeve, e ushtruar nga i dënuar, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.27.02.2023, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të dënuarit I.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PK.nr.153/2022, të dt.24.01.2023, vërtetohet.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PK.nr.153/2022, të dt.24.01.2023, është bërë bashkimi i dënimeve i formës së prerë, po të njëjtës gjykatë, PKR.69/2019, i dt.19.11.2019, i plotfuqishëm me dt.04.03.2020, aktgjykimi i P.nr.447/2020, i dt.22.07.2021, i plotfuqishëm me dt.15.10.2021, aktgjykimi i P.nr.685/2019, i dt.22.07.2021, i plotfuqishëm me dt.24.09.2021, si dhe aktgjykimi P.nr.400/2021, i dt.21.02.2022, i plotfuqishëm me dt.12.07.2022, ashtu që ndryshohet sa i përket vendimeve për dënimet me burgim, në atë mënyrë që merren si të vërtetuara dënimet me burgim dhe atë: dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.05.10.2019, deri me dt.19.11.2019, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) Euro, i shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.69/2019, i dt.19.11.2019, i plotfuqishëm me dt.04.03.2020, për shkak të veprave penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.2 të KPK, dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro, si dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i shqiptuar me aktgjykimin P.nr.447/20, të dt.22.07.2021, i plotfuqishëm me dt.15.10.2021, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 par.2 të KPRK, dënimi me gjobë në shumën prej 100 (njëqind) Euro, si dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 40 (dyzet) ditësh, i shqiptuar me aktgjykimin P.nr.685/19, i dt.22.07.2021, i plotfuqishëm me dt.24.09.2021,

për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 323 par.5 lidhur me par.1 të KPRK, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) Euro, dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, i shqiptuar me aktgjykimin P.nr.400/2021, i dt.21.02.2022, i plotfuqishëm me dt.12.07.2022, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1.1 të KPK, prandaj në kuptim të nenit 420 par.1 nën par.1.1 lidhur me par.5 të KPP, si dhe në kuptim të nenit 76 të KPRK, të akuzuarit i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.05.10.2019, deri me dt.19.11.2019, si dhe dënim unik me gjobë në shumë prej 1.400 (njëmijekatërqind) Euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i dënuari I.B., për shkak të vendimit për dënimin – bashkimit të dënimeve, duke pretenduar se në këtë çështje penale nuk është bërë vlerësimi i drejtë me rastin e bashkimit të dënimeve, ngase nuk janë zbatuar dispozitat përkatëse ligjore si dhe parimet procedurale. Po ashtu, i dënuar pretendon se në këtë çështje penale, nuk janë vlerësuar të gjitha kushtet të cilat janë paraqitur në ankesë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/I.nr.100/2023, të datës 20.02.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të dënuarit I.B., aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

#### **Ankesa e të dënuarit I.B., nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit, të cilat do të kushtëzojnë anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të dënuarit I.B., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me bashkimin e dënimeve, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë rrethanat të cilat janë të përcaktuara me dispozitën përkatëse ligjore, e po ashtu nuk ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat lehtësuese sikurse janë, gjendja ekonomike e të dënuarit, se i njëjti, me bashkimin e dënimeve, e sidomos me respektimin e parimeve për personat e dënuar, do të përfitoj nga bashkimi unik i dënimeve, e sidomos duke pasur parasysh rëndësinë procedurale në çështjen penale dhe sikurse thekson i njëjti përmirësimin e tij gjatë kohës së qëndrimit në burg, duke menduar që ti kthehet familjes së ngushtë dhe asaj më të gjerë, dhe premtuar se asnjëherë tjetër nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e të dënuarit I.B., si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në

përfundim që me aktgjykimin e ankimuar nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkeljet e ligjit penal, kurse sa i përket pretendimeve ankimore për shkak të vendimit për bashkimin të dënimeve, ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë pasi që e ka vlerësuar situatën e përgjithshme nga kjo çështje penale, e sidomos aktgjykimet e plotfuqishme, sikurse janë përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, ka ardhur në përfundim se në mënyrë të drejt janë aplikuar dispozitat përkatëse ligjore për unifikimin e dënimeve, dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi, janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore dhe me bashkimin e dënimeve, do të arrihet efekti dhe qëllim i të njëjtit i paraparë me ligj.

Ngase u tha më lartë u vendos sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, në kuptim të nenit 401 të KPPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.101/2023, të datës 27.02.2023**

**Sekretarja juridike,**  
**Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Xhevdet Abazi**

**Beqir Kalludra**